



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 11      Datë 29-1-2026

**PËR MIRATIM E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM  
FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1,111,093.19 LEKË**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, aneksit 9 “Grandi i performancës për bashkitë”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në udhëzimin e përbashkët me nr. 1031/5 datë 11.7.2025 dhe nr. 10725 datë 11.7.2025, midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”, shkresën me nr. 764 prot., datë 19.12.2025, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë grandin e bazuar në performancë, me burim financimi të huaj në vlerën 1,111,093.19 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e këtij fondi për objektin: “Ndërrhyrje, mirëmbajtje në Bibliotekën “Th. Mitko” dhe “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, Korçë, në programin Kultura, Sport dhe Argëtim, në llogarinë 2310000 me këtë strukturë buxhetore:  
SHTOHET Prog. AF122 00 02 Art. 2310000 + 1,111,093.19 lekë (Bashkia)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Pro 26

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 2

Zbardhur më datë 29-1-2026

